



***Prof. Asoc. PhD
Ardita Prendi***

Pedagoge në Departamentin
e Drejtësisë

BIOGRAFIA

Prof. Asoc. Dr. Ardita Prendi – ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Psikologji (1997–2001). Studimet Master në Psikologji Këshillimi dhe Psikologji Klinike (2004–2006). Gjithashtu, në vitin 2007 ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, dega Drejtësi. Në vitin 2016 përfundon studimet doktorale dhe merr Gradën “Doktor Shkencash” në fushën e Psikologjisë së Ligjit, me temën “Psikologjia e të miturit në konflikt me ligjin para dhe pas procesit gjyqësor”. Në vitin 2021 është licensuar nga Urdhëri i Psikologut si Psikologe dhe Supervizore. Janar 2023 merr titullin “Prof. Asoc “në Psikologji.

Ka një eksperiencë 22-vjeçare në fushën e mësimdhënies si pedagoge e jashtme pranë Departamentit Psikologji– Pedagogji, Universiteti i Tiranës, dhe në Universitetin e Mjekësisë ,Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Kolegjin Universitar “Wisdom” në programet Bachelor dhe Master Shkencor. Së fundi është pjesë përbërëse e stafit akademik me kohë të plotë e Universitetit “Barleti”.

Gjatë kësaj kohe ka marrë pjesë në shumë Shkolla Trajnimi, Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka botuar një sërë artikujsh shkencor në fushën e psikologjisë dhe atë ligjit në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Fusha e ekspertizës; Psikologji Ligji. E Drejtë penale për të mitur, Ndërhyrje në kriza dhe trauma, Neuropsikologji klinike dhe ligji.